

NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, Z. VLADIMIR MARA

06/14/2019

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore më datë 12.06.2019 për subjektin e rivlerësimit, z. Vladimir Mara, bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, më datë 14.06.2019 vendosi:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, Vladimir Mara, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë.
2. Në zbatim të pikës 4 nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, të përcjellë për vlerësimin etik dhe profesional pranë organit kompetent dy çështje për inspektim dhe konstatim të shkeljeve të mundshme disiplinore.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupi gjykues e kryesuar nga znj. Pamela Qirko, znj. Alma Faskaj relatore, znj. Firdes Shuli anëtare, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ndaj këtij vendimi, mund të ushtrohet ankimi pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.